

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ J & E 2022 G ” SH.P.K.**

Sot, më datë 18/01.2022

**Kostandin Ekonomi**, lindur ne Durres, i datëlindjes 19.10.1963, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti ID 033649645 dhe Nr.personal G31019025W.

ka përpiluar këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **“ J & E 2022 G ” SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **“ J & E. 2022 G ” SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**, (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“ J & E. 2022 G ” SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është:

- 1)-Piceri, hapjen dhe menaxhimin e Bar-Kafe, Restorante, kryerjen e sherbimeve Katering dhe administrimin e ushqimeve dhe pijeve ne pergjithesi.
- 2)- Hapjen dhe menaxhimin e dyqaneve dhe bizneseve tregtare për tregtimin me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore dhe jo ushqimore,
- 3) Import – eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore, blegtorale, industriale, makineri e pajisje, etj
- 4) Hapjen e Lavazheve per larjen e automjeteve dhe sherbime te tjera ne lidhje me to dhe parkim automjetesh.
- 5) Marrjen e perfaqesimit te Kompanive te tjera qe operojne ne kete sektor.



Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Shoqëria ka seline ligjore:

Durres, Lagjja 1, Rruga "Tregtare", ZK:8514, Godina nr.3/238.

Shoqëria mund të hape filiale, dege apo perfaqesi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashtë tij.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke (njëqindmije)lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuote.

**Z. KOSTANDIN EKONOMI** është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 100.000 leke.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet **për një afat 5 vjeçar**, me të drejte rimerimi.. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. KOSTANDIN EKONOMI**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



**NENI 8**

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 9**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 10**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhvendosin Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 11****Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

**ORTAKU THEMELUES****Z. KOSTANDIN EKONOMI**